



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.09.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.09.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" për aktivitetin: "Pastrimi i shkollave fillore" Gjergj Fishta"" Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Dardania", "Naim Frasheri", "Pjeter Bogdani", "Shkolla e Gjelbert" dhe "Mehmet Gjevori" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3237-211** nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" e datës 19.09.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore" Gjergj Fishta"" Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Dardania", "Naim Frasheri", "Pjeter Bogdani", "Shkolla e Gjelbert" dhe "Mehmet Gjevori" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3237-211** kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 17.09.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.09.2019;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" me datë 19.09.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i shkollave fillore" Gjergj Fishta"" Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Dardania", "Naim Frasheri", "Pjeter Bogdani", "Shkolla e Gjelbert" dhe "Mehmet Gjevori" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3237-211**. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.09.2018 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


-Pretendimi i parë lidhur me mosplotësimin e kërkesave teknike, respektivisht mosprezentimin i listës së kontratave është plotësisht i pabazuar pasi që grupi i OE-ik i rekomanduar për kontratë ka paraqitur listën e kontratave për secilin anetar veç e veç me të gjitha të dhenat e kërkuara në dosjen e tenderit;

- Pretendimi se i rekomanduari per kontrate ka deklaruar pervojen e punes ne vlere mujore prej 1,147.00 euro eshte poashtu e pa bazuar pasiqe AK-ja ka analizuar dhe konstatuar se çmimi i dhene ne tenderin e tij e mbulon edhe kerkesen e ndryshuar te Autoritetit Kontraktues prej 1,390.00 euro dhe per kete eshte trajtuar si e pranueshme;
- Pretendimi tjetër për mosplotesim të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare poashtu është i pa bazuar pasi që i propozuari për kontrate ka dorezuar një nga deshmite e paraqitura në nenin 68 të LPP-ik respektivisht ka paraqitur referenca nga Institucionet publike në vlerën totale mbi vlerën e kërkuar të qarkullimit financiar;
- Pretendimi për mungesën e certifikatave të kërkuara poashtu është i pa bazuar sepse Autoriteti Kontraktues duke vepruar sipas nenit 39.8 të RRUOPP-se ka kërkuar sqarime plotësues dhe i propozuari për kontrate ka dorezuar të gjitha certifikatat e kërkuara;
- Lidhur me pretendimin për mungesë të noterizimit për listen e mjeteve poashtu është kërkuar sqarim dhe i propozuari për dhenje të kontratës ka dorezuar deshmime të noterizimit;
- Pretendimi për mungesë të certifikatave për punetoret poashtu është i pa bazuar pasiqe decidivisht në dosjen e tenderit është cekur se të njëjtat do të kerkohen nga fituesi i tenderit dhe kështu është vepruar dhe të njëjtat janë sjellur nga tenderuesi i rekomanduar për kontrate;dhe
- Pretendimi për çmim jonormalisht të ulët poashtu nuk është i bazuar pasiqe për trajtimin e këtij çmimi si të tillë nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore dhe për kësaj është konstatuar nga AK-ja se çmimi i dhënë i mbulon pagat e kërkuara bruto,pagesen për përvje të punës dhe TVSH-ne.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit